



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:277492

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05506857

C.nr.1442/2023

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.G nga Obiliqi, të cilin e përfaqëson e autorizuar F.B, avokate me seli në Vushtri, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Arsimit me seli në Vushtri, të cilën e përfaqëson Bastri Duraku, me objekt kontesti kompensim të ushqimit-shujtave dhe për 70% të shpenzimeve të udhëtimit-rrugës, për ditët e pranisë në punë, me vlerë të objektit të kontestit 1,035.00 euro, jashtë seance, më datë 26.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.G dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditësit, t'ia kompensoj:

a) Në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë për 325 ditë pune dhe atë për periudhën kohore nga data 30.03.2021 e deri me datë 21.11.2022, shumën prej 650.00 euro.

b) Në emër të 70% të shpenzimeve të rrugës-udhëtimit për ditët e pranisë në punë për 275 ditë pune dhe atë për periudhën kohore nga data 19.03.2021 e deri me datë 21.11.2022, shumën prej 385.00 euro.

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë me datë 12.12.2023, e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditësit A.G, në emër të shpenzimeve të procedurës, të ia paguaj shumën në vlerë prej 124.00 euro, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi me datë 12.12.2023, përmes përfaqësueses së saj të autorizuar, ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti për

kompensim të shpenzimeve të ushqimit-shujtave dhe 70% të shpenzimeve të udhëtimit-rrugës për ditët e pranisë në punë.

### *Pretendimet e palëve*

Paditësi përmes padisë, ka kërkuar që gjykata ta detyroj të paditurën që duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit nr 105, të datës 21.01.2021 (Tani e tutje KKA) t'ia paguaj asaj kompensimin në emër të shujtave për ditët e pranisë në punë prej dy (2) euro në ditë dhe atë për 325 ditë pune në periudhën kohore nga data 30.03.2021 e deri me datë 21.11.2022, në shumën prej 650.00 euro, kurse për shkak të shpenzimeve ditore prej dy (2) euro në ditë për 275 ditëve të punës gjatë periudhës kohore nga data 19.03.2021 e deri me datë 21.11.2022, ka kërkuar 70% të këtyre shpenzimeve, në shumën prej 385.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë me datë 12.12.2023, e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Përmes përgjigjes në padi së të autorizuarit të së paditurës Basri Duraku, të datës 12.03.2024, e paditura ka kërkuar që gjykata ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar me arsyetimin se të paditurës i mungon legjitimacioni pasiv për të qenë palë në këtë procedurë kontestimore sepse ajo nuk ka qenë pjesëmarrëse në marrëdhëniet detyimore dhe nuk ka marrë obligime për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga KKA-ja por që këtë e kanë bërë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) të cilat nuk kanë përmbushur obligimet e kësaj Kontrate, për të siguruar mjete buxhetore për Komunitat. Përpos kësaj ka shtuar se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017 dhe ka qenë në fuqi deri më datë 18.04.2020, konkretisht sipas mendimit juridik të Gjykatës Supreme nr. 40/2023, deri më datë 21.01.2021 dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date, ndërsa paditësi e ka paraqitur padinë në gjykatë pas këtij afati kur efektet Kontratës Kolektive të Arsimit kanë pushuar. E paditura këtë e bazon në nenin 90.4 të Ligjit të Punës sipas të cilit theksohet se "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet*" nenit 87 të këtij ligji që ka paraparë që "*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*" dhe nenit 342 Të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku thuhet se "*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*".

Ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës ka theksuar që të njëjtat i bartë paditësi.

### *Provat*

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka vlerësuar dhe administruar këto prova: Kontrata e punës nr.10/29

e datës 06.09.2018, e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës, Vërtetimi nr.02/626, i datës 20.10.2023, i lëshuar nga Shkolla e Mesme Ulët “SHMU-2”, në Vushtrri, për ditët e punës së paditësit lidhur me kompensimin e shujtës, Vërtetimi nr.02/629, i datës 20.10.2023, i lëshuar nga Shkolla e Mesme Ulët “SHMU-2”, në Vushtrri, për ditët e punës së paditësit lidhur me kompensimin e udhëtimit si dhe Vërtetimi i udhëtimit i lëshuar nga N.P.T “B...”, i datës 19.10.2023 në emër të paditësit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, provave të propozuara si dhe përgjigjes në padi në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### *Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës*

Në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësi kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura për gjatë kësaj periudhe për të cilën e ka kërkuar kompensimin si dhe vendbanimi i paditësit. Po ashtu nuk ishin kontestuese as ditët e pranisë në punë nga paditësi, këto të vërtetuara edhe nga vërtetimi për ditët e punës, të cilës provë gjykata ia fali besimin e plotë duke u bazuar edhe në nenin 329.1, të LPK-së, në të cilin përcaktohet që “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”, pasi janë lëshuar nga institucionet arsimore të së paditurës.

Kontestuese në mes palëve ishte fakti nëse pala e paditur ka legjitimitet pasiv në këtë çështje kontestimore dhe nëse kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar. Pra në këtë procedurë për gjykatën ishte e rëndësishme që ta vërtetoj bazën ligjore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe besueshmërinë e saj me prova e po ashtu edhe pretendimet e palës së paditur se ajo nuk ka legjitimitet për të qenë palë në këtë procedurë dhe se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar.

Duhet theksuar se sipas vlerësimit të gjykatës, e drejta e paditësit për kompensimin në emër të udhëtimit-rrugës dhe të shujtave për ditët e punës që përfshinë periudhën kohore nga 19.03.2021 e deri me datë 21.11.2022, është e bazuar në KKA-në nr.105, e datës 22.01.2021. Kjo ngase gjatë periudhës kohore për të cilën paditësi e kërkon kompensimin ka qenë në fuqi kjo KKA.

Sa i përket bazueshmërisë së kërkesëpadisë së paditësit për çështjen e shujtave-ushqimit, e njëjta rrjedh nga neni 35.7 i KKA-së nr. 105 sipas të cilit nen përcaktohet se “*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit, kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim.*”, prandaj gjykata ka vendosur që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitivin I, pika a), sepse i njëjti për periudhën kohore nga data

30.03.2021 e deri me datë 21.11.2022, sipas Vërtetimit nr.02/626, i datës 20.10.2023, i lëshuar nga Shkolla e Mesme Ulët “SHMU-2”, në Vushtrri, për ditët e punës së paditësit lidhur me kompensimin e shujtës, ka pasur 325 ditë të pranisë në punë dhe në bazë të një kalkulimi të 325 ditëve të punës, shumëzuar për vlerën prej dy (2) euro në ditë, rezulton se detyrimi i të paditurës për paditësen, në emër të kompensimit për ushqimit në punë të jetë 650.00 euro.

Gjykata e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit edhe sa i përket kërkesës për kompensimin në emër të shpenzimeve të udhëtimit sepse kjo e drejtë rrjedh nga neni 35.5 i KKA-së nr. 105 e datës 22.01.2021, sipas të cilit përcaktohet se *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*, prandaj gjykata ka vendosur që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, si në dispozitivin I pika b) e këtij aktgjykimi sepse ai i ka provuar ditët e punës dhe shpenzimet e udhëtimit gjatë periudhës kohore nga data 19.03.2021 e deri me datë 21.11.2022.

Konkretisht sipas Vërtetimit nr.02/629, i datës 20.10.2023, i lëshuar nga Shkolla e Mesme Ulët “SHMU-2”, në Vushtrri, për ditët e punës së paditësit lidhur me kompensimin e udhëtimit, ai gjatë periudhës kohore të lartcekur ka pasur 275 ditë të pranisë në punë dhe ka udhëtuar në relacionin Milloshevi-Vushtrri dhe anasjelltas, në të cilat ditë të punës, sipas Vërtetimit të udhëtimit i lëshuar nga N.P.T “B...”, i datës 19.10.2023 në emër të paditësit për shkak të udhëtimit në relacionin Milloshevi-Vushtrri dhe anasjelltas ka pasur shpenzime të udhëtimit prej dy (2) euro në ditë, dhe rezulton se detyrimi i të paditurës për paditësin, në emër të kompensimit për udhëtim në punë është 385.00 euro, që është 70% i shpenzimeve totale të udhëtimit (550.00 euro) për këtë periudhë kohore (550.00 euro - 30% = 385.00 euro).

Lidhur me kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit gjykata ka vlerësuar se as me dispozitën e nenit 35.5 të KKA-së nr. 105 e datës 22.01.2021, sipas të cilit përcaktohet se *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*, e as me asnjë dispozitë tjetër të KKA-së, nuk parashihet se përfitues të kësaj të drejte konkrete janë vetëm punëtorët që udhëtojnë brenda vendbanimeve të komunës ku ata punojnë, kurse punëtorët që udhëtojnë nga komunat e tjera përjashtohen nga kjo e drejtë sepse të drejtat që dalin nga KKA-ja, janë të zbatueshme të për gjithë punëtorët e arsimit. Me dispozitën e nenit 2.1.1 të KKA-së nr. 105, është përcaktuar që *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, kurse me pikën 1.2 të këtij neni të thuhet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*.

Pra KKA-ja është e zbatueshme për të gjithë punëtorët e arsimit pa dallim dhe në asnjë mënyrë një dispozitë e caktuar nuk mund të interpretohet si përjashtim i disa të punësuarave për

shfrytëzimin e të drejtës për tu kompensuar për udhëtimin e tyre për në vendin e punës vetëm për faktin se nuk është me vendbanim në komunën ku është punësuar sepse një qasje e tillë është në kundërshtim edhe me nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konkretisht paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, ku përcaktohet që *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”*, lidhur me nenin 3, paragrafin 2 të Ligjit nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas të cilës dispozitë parashihet që *“Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës”*, sepse në këtë mënyrë disa të punësuar të arsimit që janë me vendbanim në Komunën ku punojnë do të kompensoheshin për shpenzimet e udhëtimit, kurse kolegët e tyre në pozita të njëjta nuk do të përfitonin nga kjo e drejtë vetëm për faktin se janë me vendbanim në një komunë tjetër.

Detyrimi i të paditurës ndaj paditësit është e përcaktuar edhe me nenin 8.1 të Ligjit nr 04/1-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është përcaktuar që *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*, kurse me nenin 245 të LMD-së është paraparë që *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e që në këtë rast e paditura është e detyruar që të përmbushë një detyrim ndaj paditësit, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në anën tjetër për gjykatën nuk mund të qëndroj pretendimi i të paditurës se pasi që ajo nuk ka qenë nënshkruese e Kontratës Kolektive, asaj i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje. Kjo ngase në radhë të parë e paditura është punëdhënësi i paditësit dhe të njëjtit janë në një raport kontraktual të marrëdhënies së punës e po ashtu faktit se KKA-ja është e lidhur në nivel vendi, me efekt të zbatueshëm në të gjithë Republikën e Kosovës. Lidhur me këtë, me nenin 90, par 2.1 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, është paraparë që *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në nivel të vendit”* dhe mbi këtë bazë kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në Kontratën Kolektive nr. 105, e datës 22.01.2021, të lidhura në mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në njërin anë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) në anën tjetër.

Sa i përket kundërshtimit të të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, gjykata të njëjtin e vlerësoj si të pa bazuar, pasi e paditura lidhur me këtë kundërshtim i është referuar KKA-së, nr. 2056 e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe ka qenë në fuqi deri më 21.01.2021, ndërsa e drejta e paditësit për kërkesat për kompensimin e ushqimit-shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit, që përfshinë periudhën kohore nga data 19.03.2021 e deri me datë 21.11.2022, është e bazuar në KKA-në nr. 105, që ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Se ky

kundërshtim nuk është i bazuar konstatohet edhe me nenin 87 të Ligjit e Punës, është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, kurse në rastin konkret paditësi për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit-shujtave dhe të udhëtimit për ditët e kaluara në punë që përfshinë periudhën kohore nga data 19.03.2021 e deri me datë 21.11.2022, e ka paraqitur padinë më datë 12.12.2023, pra kërkesat e paditësit për kompensim janë brenda afatit ligjor sepse nuk e kanë kaluar afatin prej tre vitesh ashtu siç përcaktohet me nenin 87 Ligjit të Punës dhe nuk janë parashkruar.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 265/2020 i datës 02.12.2020 paditësit i'a njohu edhe të drejtën në kamatë ligjore, në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 12.12.2023, si dita e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë e deri në pagesën definitive.

Lidhur me shpenzimet e procedurës si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 449 të LPK-së e po ashtu nenit 452.1, të LPK-së sipas të cilit përcaktohet që *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, ashtu e paditura duhet që paditësit të ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore në shumë prej 20.00 euro, në shumë të përgjithshme prej 124.00 euro.

Gjykata vendosi që këtë çështje kontestimore ta vendos jashtë seancës gjyqësore ashtu siç është përcaktuar me nenin 398 të LPK-së, e cila parasheh që: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ngase thëniet e paditësit lidhur me gjendjen faktike në padi për ditët e punës u vërtetuan me provat e propozuara nga ajo, të cilat prova janë lëshuar nga institucionet arsimore të së paditurës, që nuk janë kontestuar as nga pala e paditur dhe në këtë mënyrë e bënë të themeltë edhe kërkesëpadinë e paditësit. Kurse fakti se e paditura e ka kontestuar kërkesëpadinë mbi bazën e legjitimitetit pasiv dhe faktit se sipas nenit 35.5 të KKA-së, e drejta e kompensimit të udhëtimit i'u takon vetëm punëtorëve që udhëtojnë brenda Komunës së Vushtrrisë (transporti urban) nuk është pengesë për të marrë aktgjykim jashtë seance sepse këto kundërshtime janë vetëm prezumime ligjore, të cilat ashtu siç u tha më lartë janë të pabazuara.

Gjykata ka vlerësuar se marrja e aktgjykimit pa mbajtur seancë gjyqësore është në harmoni edhe me praktikën e ndërtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila praktikë është obligim që të zbatohet nga Institucionet e Republikës së Kosovës. Kjo duke u bazuar në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thuhet se *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Në rastin [Jussilia kundër Finlandës](#), nr.73053/01, pika 41, GJEDNJ ka konstatuar se mund të ketë procedura gjyqësore në të cilat mund të mos mbahet një seancë dëgjimore, siç mund të jenë rastet kur nuk janë kontestuese çështjet e besueshmërisë ose fakteve dhe gjykatat mund të vendosin çështjen në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme vetëm në bazë të parashtrësive të palëve dhe materialeve tjera të shkruara, e po ashtu në rastin [Saccasia kundër Austrisë](#), nr.69917/01, pika 76, është konstatuar nga GJEDNJ se mos mbajtja e seancës gjyqësore mund të justifikohet në rastet që ngrenë apo kontestohen thjesht çështje ligjore të një natyre të kufizuar.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 398 të LPK-së dhe praktikën e GJEDNJ-së, përderisa e paditura në kundërshtimet e saj me përgjigje në padi ka kontestuar vetëm çështje materiale-ligjore, siç janë parashkrimi dhe legjitimiteti, sipas vlerësimit të gjykatës mbajtja e seancave gjyqësore është e panevojshme ndërsa vendosja lidhur me çështjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka mundur të realizohet mjaftueshëm edhe jashtë seance vetëm përmes shkresave të lëndës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2023:277492, C.nr.1442/2023, me datë 26.03.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Leotrim Gashi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh, pas ditës së pranimi të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.